Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale

e 20 Mars 1883,

rishikuar
në Bruksel më 14 dhjetor 1900, në Uashington më
2 qershor 1911, në Hagë më 6 Nëntor 1925,
në Londër më 2 qershor 1934, në Lisbon më 31 Tetor 1958,
dhe në Stokolm më 14 Korrik 1967,
dhe e ndryshuar më 28 shtator 1979

TABELA E PËRMBAJTJES*

Neni 1: Themelimi i Unionit; Fusha e zbatimit të Pronësisë Industriale

Neni 2: Trajtimi Kombëtar për Shtetasit e Vendeve të Unionit
Neni 3: Trajtim i njëjtë për kategori të caktuara të personave si për shtetasit e vendeve të Unionit

Neni 4: A. në I. Patentat, Modelet e përdorimit, dizenjot industriale, Markat, Certifikatat e shpikësit: E drejta e Prioritetit.– G. Patentat: Sektori i Aplikimit

Neni 4bis: *Patentat*: Pavarësia e patentave të marra për të njëjtën shpikje në Shtete të ndryshme

Neni 4ter: *Patentat*: Përmendja e shpikësit në patentë

Neni 4quater: *Patentat*: Patentueshmëria në rast të kufizimeve të shitjes nga ligji

Neni 5: A *Patentat*: Importimi i mallrave;Mospërdorimi(mosshfrytëzimi) ose përdorimi i pamjaftueshëm; Licencat e Detyrueshme. – B. *Dizenjot industriale*: Mospërdorimi(mosshfrytëzimi); Importimi i Mallrave. – C. *Markat*: Mospërdorimi; Forma të ndryshme; Përdorimi nga bashkëpronarët. – D. *Patentat, Modelet e Përdorimit, Markat, Dizenjot Industriale:* Shënime

Neni 5bis: *Periudha e mospagimit për pagesën e tarifave për ruajtjen e të drejtave; Patentat:* Rivendosja e të drejtave

Neni 5ter: *Patentat*: *:* Pajisjet e patentuara që përbëjnë pjesë të anijeve, avionëve ose automjeteve tokësore

Neni 5quater: *Patentat*: Importimi i produkteve të prodhuara nga një proces i patentuar në vendin importues

Neni 5quinquies: Dizejot industriale

Neni 6: *Markat*: Kushtet e Regjistrimit; Pavarësia e mbrojtjes së të njëjtës marke në vende të ndryshme

Neni 6bis: *Markat*: Markat e mirënjohura

Neni 6ter: *Markat*: Ndalimet në lidhje me emblemat shtetërore, shenjat zyrtare dhe emblemat e organizatave ndërqeveritare

Neni 6quater: *Markat*: Transferimi i markave

Neni 6quinquies: *Markat*: Mbrojtja e markave që janë regjistruar në një shtet të Unionit, në vendet e tjera të Unionit

Neni 6sexies: *Markat*: Markat e Shërbimit

Neni 6septies: *Markat*: Regjistrimi në emër të agjentit ose përfaqësuesit të pronarit pa autorizimin e këtij të fundit

Neni 7: *Markat*: Natyra e Mallrave për të cilat është aplikuar Marka

Neni 7bis: *Markat*: Markat Kolektive

Neni 8: *Emra Tregëtare*

Neni 9: *Markat, Emrat Tregtarë:* Konfiskimi Importi, etj., i mallrave që mbajnë në mënyrë të paligjshme një markë ose emër tregtar

Neni 10: *Indikacione të rreme:* Konfiskimi, në import, etj., i mallrave që përmbajnë indikacion të rremë për prejardhjen e tyre ose identitetin e prodhuesit

Neni 10bis: *Konkurrenca e pandershme*

Neni 10ter: *Markat, Emrat tregtarë, Indikacionet e rreme, Konkurrencë e pandershme:* mjete juridike, e drejta për të paditur

Neni 11: *Shpikjet, Modelet e përdorimit, Modelet industriale, Markat*: Mbrojtje e përkohshme në disa ekspozita ndërkombëtare

Neni 12: Shërbime të Posaçme Kombëtare të Pronësisë Industriale

* Tabela e përmbajtjes është shtuar për lehtësinë e lexuesit. Nuk përfshihet në tekstin e nënshkruar të Konventës.

Neni 13: Kuvendi i Unionit
Neni 14: Këshilli Ekzekutiv
Neni 15: Byroja Ndërkombëtare
Neni 16: Financat
Neni 17: Rishikimi i Nenit 13 deri në 17
Neni 18: Rishikimi i Nenit 1 deri në 12 dhe 18 deri në 30
Neni 19: Marrëveshje të veçanta
Neni 20: Ratifikimi ose aderimi nga vendet e Unionit; Hyrja në fuqi
Neni 21: Aderimi nga vendet jashtë Unionit; Hyrja në fuqi
Neni 22: Pasojat e Ratifikimit ose Aderimit
Neni 23: Aderimi në aktet e mëparshme
Neni 24: Territoret
Neni 25: Zbatimi i Konventës në nivelin e brendshëm
Neni 26: Anullimi i marrëveshjes (tërheqja)
Neni 27: Zbatimi i akteve të mëparshme
Neni 28: Mosmarrëveshjet
Neni 29: Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e depozitimit
Neni 30: Dispozitat kalimtare

Neni 1
[Themelimi i Unionit; Fusha e zbatimit të Pronësisë Industriale][1])

(1) Shtetet ndaj të cilave zbatohet kjo Konventë përbëjnë një Union për mbrojtjen e pronësisë industriale.

(2) Mbrojtja e pronësisë industriale ka për objekt patentat, modelet e përdorimit, dizenjot industriale, markat tregtare, markat e shërbimit, emrat tregtarë, treguesit e burimit ose emërtimet e origjinës si dhe mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme.

(3) Pronësia industriale ka kuptim më të gjerë dhe do të zbatohet jo vetëm për industrinë dhe tregtinë, por gjithashtu për degët e industrisë bujqësore dhe nxjerrëse dhe për të gjitha produktet e përpunuara ose natyrore, për shembull, verërat, drithërat, gjethet e duhanit, frutat, bagëtinë, mineralet, ujërat minerale, birrën, lulet dhe miellin.

(4) Patentat do të përfshijnë lloje të ndryshme të patentave industriale të njohura nga ligjet e shteteve të Unionit, të tilla si patenta të importit, patenta për përmirësim, patenta dhe certifikata plotësuese, etj.

Neni 2
[Trajtimi Kombëtar për Shtetasit e Vendeve të Unionit]

(1) Për sa i përket mbrojtjes së pronësisë industriale, shtetasit e çdo vendi të Unionit në të gjitha vendet e tjera të Unionit do të gëzojnë dobitë që ligjet e tyre përkatëse u japin shtetasve, ose mund t'u japin më pas; por nga kjo të mos shkelen të drejtat veçanërisht të parashikuara me këtë konventë. Rrjedhimisht, ata do të kenë të njëjtën mbrojtje dhe të njëjtin mjet juridik kundër çdo cenimi të të drejtave të tyre, me kusht që të respektohen kushtet dhe formalitetet e vendosura ndaj shtetasve.

(2) Megjithatë, shtetasve të vendeve të Unionit nuk mund t'u vendoset asnjë kërkesë në lidhje me vendqëndrimin ose vendosjen në vendin ku kërkohet mbrojtja për të gëzuar çdo të drejtë të pronësisë industriale.

(3) Shprehimisht përjashtohen dispozitat e ligjeve të secilit prej shteteve të Unionit në lidhje me procedurën gjyqësore dhe administrative dhe të kopetencës, si dhe për caktimin e një adrese për shërbim ose caktimin e një përfaqësuesi, i cili mund të kërkohet nga ligjet për pronësinë industriale.

[1] Neneve u janë dhënë tituj për të lehtësuar identifikimin e tyre. Nuk ka tituj në tekstin e nënshkruar (frëngjisht)

Neni 3

[Trajtim i njëjtë për kategori të caktuara të personave si për shtetasit e vendeve të Unionit]

Shtetasit e vendeve jashtë Unionit të cilët kanë vendqëndrim ose që kanë ndërmarrje të vërteta dhe serioze industriale ose tregtare në territorin e një prej vendeve të Unionit do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si shtetasit e vendeve të Unionit.

Neni 4

[A në I. Patentat, Modelet e Përdorimit, Dizenjot industriale, Markat, Certifikatat e shpikësve: E drejta e prioritetit. - G. Patentat: Sektori i Aplikimit]

A.—

(1) Çdo person që ka paraqitur një aplikim të rregullt për patentë, ose për regjistrimin e një modeli përdorimi, të një dizenjo industriale, ose të një marke tregtare, në një nga vendet e Unionit, ose pranuesi i tij i të drejtave, do të gëzojë të drejtën e prioritetit për paraqitjen e aplikimit në vendet e tjera, gjatë periudhave të përcaktuara më poshtë.

(2) Çdo paraqitje e kërkesës për aplikim që është ekuivalente me një kërkesë të rregullt sipas legjislacionit të brendshëm kombëtar të një vendi të Unionit ose sipas traktateve dypalëshe ose shumëpalëshe të lidhura ndërmjet vendeve të Unionit do të pranohet si e drejtë e prioritetit.

(3) Me një paraqitje të rregullt kombëtare të kërkesës për aplikim nënkuptohet çdo kërkesë që është e përshtatshme për të përcaktuar datën në të cilën është paraqitur aplikimi në vendin në fjalë, çfarëdo që të jetë fati pasues i aplikimit.

B. — Rrjedhimisht, çdo aplikim i mëvonshëm në ndonjë nga vendet e tjera të Unionit përpara përfundimit të periudhave të përmendura më sipër nuk do të shfuqizohet për shkak të ndonjë akti të kryer në atë interval kohe, në veçanti, një kërkese tjetër për aplikim, publikimi ose përdorimi i shpikjes, vënia në shitje e kopjeve të dizenjos, ose përdorimi i markës, dhe akte të tilla nuk mund të krijojnë asnjë të drejtë të palës së tretë ose ndonjë të drejtë të posedimit personal. Të drejtat e fituara nga palët e treta përpara datës së kërkesës së aplikimit të parë që shërben si bazë për të drejtën e prioritetit janë të rezervuara në përputhje me legjislacionin e brendshëm të çdo vendi të Unionit.

C.—

(1) Periudhat e prioritetit të përmendura më sipër do të jenë dymbëdhjetë muaj për patentat dhe modelet e përdorimit, dhe gjashtë muaj për dizenjot industriale dhe markat tregtare.

(2) Këto afate fillojnë nga data e paraqitjes së aplikimit të parë; dita e paraqitjes nuk do të përfshihet në afat.

(3) Nëse dita e fundit e afatit është festë zyrtare, ose një ditë kur Zyra nuk është e hapur për paraqitjen e aplikimit në vendin ku kërkohet mbrojtja, afati zgjatet deri në ditën e parë pasuese të punës.

(4) Një aplikim pasues në lidhje me të njëjtën temë si një aplikim i parë i mëparshëm sipas kuptimit të paragrafit (2) më sipër, i paraqitur në të njëjtin vend të Unionit do të konsiderohet si aplikimi i parë. Data e paraqitjes të tij do të jetë pika e fillimit të periudhës së prioritetit, nëse, në momentin e paraqitjes së aplikimit pasues, aplikimi i mëparshëm në fjalë është tërhequr, braktisur ose refuzuar, pa qenë i hapur për publikun dhe të mos ketë shërbyer si bazë për kërkesë të së drejtës së prioritetit. Aplikimi i mëparshëm nuk mund të shërbejë më pas si bazë për të kërkuar të drejtën e prioritetit.

D.—

(1) Çdo person që dëshiron të përfitojë nga prioriteti i një aplikim të mëparshëm do ti duhet të bëjë një deklaratë që tregon datën e paraqitjes së kërkesës për aplikim dhe vendin në të cilin është bërë. Çdo shtet do të përcaktojë datën (afatin) e fundit në të cilën duhet bërë një deklaratë e tillë.

(2) Këto të dhëna do të përmenden në publikimet e nxjerra nga organi kompetent, dhe në veçanti në patentat dhe specifikimet në lidhje me to.

(3) Vendet e Unionit mund t'i kërkojnë çdo personi që bën një deklaratë prioriteti të paraqesë një kopje të aplikimit (përshkrim, draft, etj.) të depozituar më parë. Kopja, e vërtetuar si e saktë nga autoriteti që ka marrë këtë kërkesë, nuk kërkon ndonjë verifikim vërtetësie tjetër dhe në çdo rast mund të depozitohet, pa pagesë, në çdo kohë brenda tre muajve nga depozitimi i aplikimit pasues. Mund të kërkohet që ajo të shoqërohet me një vërtetim për datën e depozitimit nga i njëjti autoritet dhe me një përkthim.

(4) Për deklarimin e prioritetit në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk mund të kërkohen

formalitete të tjera. Secili shtet i Unionit do të përcaktojë pasojat e moszbatimit të formaliteteve të përcaktuara në këtë Nen, që këto pasoja në asnjë rast të mos sjellin humbjen e të drejtës së prioritetit.

(5) Më pas, mund të kërkohen prova të mëtejshme.

Çdo person që përfiton nga prioriteti i një aplikimi të mëparshëm do t'i kërkohet të specifikojë numrin e atij aplikimi; ky numër do të publikohet siç parashikohet në paragrafin (2) më sipër.

E.—

(1) Kur një dizenjo industriale është paraqitur në një shtet në bazë të së drejtës së prioritetit bazuar në paraqitjen e modelit të përdorimit, periudha e prioritetit është e njëjtë me atë të caktuar për dizenjot industriale.

(2) Për më tepër, lejohet paraqitja e një modeli përdorimi në një vend në bazë të së drejtës së prioritetit bazuar në paraqitjen e një aplikimi për patentë, dhe anasjelltas.

F. — Asnjë shtet i Unionit nuk mund të refuzojë një prioritet ose një aplikim për patentë me arsyetimin se aplikanti është duke pretenduar prioritete të shumta, edhe nëse ato janë me origjinë nga vende të ndryshme, ose me arsyetimin se një aplikim që pretendon se ka një ose më shumë prioritete përmban një ose më shumë elementë që nuk janë përfshirë në aplikimin ose në aplikimet prioriteti i të cilave pretendohet, me kusht që në të dyja rastet të ketë unitet shpikjeje në kuptimin e ligjit të vendit.

Në lidhje me elementët që nuk përfshihen në aplikim ose aplikimet, prioriteti i të cilave pretendohet, depozitimi i aplikimit pasues do të krijojë të drejtën e prioritetit në kushte të zakonshme.

G.—

(1) Nëse në procesin e ekzaminimit del se një aplikim për një patentë përmban më shumë se një shpikje, aplikanti mund ta ndajë aplikimin në një numër të caktuar aplikimesh të veçanta dhe të ruajë si datë të secilit datën e aplikimit fillestar dhe përfitimin e të drejtën e prioritetit, nëse ka.

(2) Aplikuesi gjithashtu, me iniciativën e tij, mundet të ndajë një aplikim për patentë dhe të ruajë si datë të çdo aplikimi të veçantë datën e aplikimit fillestar dhe përfitimin e të drejtës së prioritetit, nëse ka. Çdo vend i Unionut do të ketë të drejtën të përcaktojë kushtet në të cilat do të autorizohet një ndarje e tillë.

H. — Prioriteti nuk mund të refuzohet me arsyetimin se disa elementë të shpikjes për të cilat pretendohet prioriteti nuk janë midis pretendimeve të formuluara në aplikim në vendin e origjinës, me kusht që dokumentet e aplikimit në tërësi zbulojnë në mënyrë specifike elemente të tilla.

I.—

(1) Kërkesat për certifikatat e shpikësit të paraqitura në një vend në të cilin aplikantët kanë të drejtë të aplikojnë sipas dëshirës së tyre qoftë për patentë ose për certifikatë shpikësi, do të krijojnë të drejtën e prioritetit të parashikuar nga ky Nen, në të njëjtat kushte dhe me të njëjtat efekte si aplikimet për patenta.

(2) Në një shtet në të cilin aplikantët kanë të drejtë të aplikojnë sipas dëshirës së tyre qoftë për patentë ose për certifikatë shpikësi, aplikanti për certifikatë shpikësi, në përputhje me dispozitat e kësaj Neni për aplikimet për patentë, gëzon një të drejtë prioriteti bazuar në një aplikim për një patentë, një model përdorimi ose një certifikatë shpikësi.

Neni 4[bis]

[*Patentat:* Pavarësia e patentave të marra për të njëjtën shpikje në vende të ndryshme]

(1) Patentat e aplikuara në vende të ndryshme të Unionit nga shtetas të vendeve të Unionit do të jenë të pavarura nga patentat e marra për të njëjtën shpikje në vende të tjera, qofshin anëtarë të Unionit apo jo.

(2) Dispozita e mësipërme duhet kuptuar në një kuptim të pakufizuar, në veçanti, në kuptimin që patentat për të cilat aplikohen gjatë periudhës së prioritetit janë të pavarura, si për sa i përket shkaqeve për pavlefshmërinë dhe konfiskimin, ashtu edhe për sa i përket kohëzgjatjes normale të tyre.

(3) Dispozita zbatohet për të gjitha patentat që ekzistojnë në kohën e hyrjes në fuqi.

(4) Në mënyrë të ngjashme, ai do të zbatohet, në rastin e aderimit të vendeve të reja, për patentat që ekzistojnë në të dyja anët në kohën e aderimit..

(5) Patentat e marra me prioritet do të kenë, në vende të ndryshme të Unionit, një kohëzgjatje të barabartë me atë që do të kishin, nëse do të ishin aplikuar ose dhënë pa përfitimin e prioritetit.

Neni 4ter

[*Patentat:* Përmendja e shpikësit në patentë]

Shpikësi ka të drejtë të përmendet si i tillë në patentë.

Neni 4^{quater}

[*Patentat:* Patentueshmëria në rast të kufizimeve të shitjes me ligj]

Dhënia e një patente nuk do të refuzohet dhe një patentë nuk do të zhvlerësohet me arsyetimin se shitja e produktit të patentuar ose e një produkti të marrë me anë të një procesi të patentuar është subjekt i kufizimeve ose kufizimeve që rrjedhin nga ligji i brendshëm.

Neni 5

[A. *Patentat:* Importimi i mallrave; Mospërdorimi ose përdorimi i pamjaftueshëm ; Licencat e Detyrueshme. —
B. *Dizajnet Industriale:* Dështimi në punë; Importimi i mallrave— C. *Markat: Mospërdorimi ose përdorimi i pamjaftueshëm*; Forma të ndryshme; Përdorimi nga bashkëpronarët. — D. *Patentat, Modelet e Përdorimit, Markat, Dizenjot Industriale:* Shënime]

A.—

(1) Importimi nga pronar patente, në vendin ku është dhënë patenta i mallrave të prodhuar në ndonjë nga vendet e Unionit nuk do të sjellë humbjen e patentës.

(2) Çdo vend i Unionit ka të drejtë të marrë masa legjislative që parashikojnë dhënien e licencave të detyrueshme për të parandaluar abuzimet që mund të ndodhin me ushtrimin e të drejtave ekskluzive të dhëna nga patenta, për shembull, mospërdorimi (mosshfrytëzimi).

(3) Nuk mund të parashikohet konfiskimi i patentës përveç në rastet kur dhënia e licencave të detyrueshme nuk do të ishte e mjaftueshme për të parandaluar keqpërdorimet në fjalë. Përpara përfundimit të dy viteve nga dhënia e licencës së parë të detyrueshme nuk mund të fillohet asnjë procedim për konfiskimin ose revokimin e një patente.

(4) Për licencë të detyrueshme nuk mund të aplikohet për shkak të mospërdorimit(mosshfrytëzimit) ose përdorimit të pamjaftueshëm para përfundimit të një periudhe prej katër vjetësh nga data e paraqitjes së aplikmit për patentë ose tre vjet nga data e dhënies së patentës, cilado periudhë që skadon e fundit; nëse pronar patente e arsyeton mosshfrytëzimin me arsye ligjore do të refuzohet. Një licencë e tillë e detyrueshme do të jetë joekskluzive dhe nuk do të jetë e transferueshme, as në formën e dhënies së nënlicencës, përveç asaj pjese të ndërmarrjes që e shfrytëzon këtë licencë.

(5) Dispozitat e mësipërme do të zbatohen, mutatis mutandis, edhe për modelet e përdorimit.

B. — Mbrojtja e dizenjove industriale, në asnjë rrethanë, nuk do t'i nënshtrohet asnjë konfiskimi, qoftë për shkak të mosshfrytëzimit ose për shkak të importimit të mallrave që janë të njëjtë me mallrat që mbrohen.

C.—

(1) Nëse, në ndonjë vend, përdorimi i markës së regjistruar është i detyrueshëm, regjistrimi mund të anulohet vetëm pas një periudhe të arsyeshme, dhe atëherë vetëm nëse personi në fjalë nuk e arsyeton mospërdorimin e tij.

(2) Përdorimi i një marke tregtare nga pronari në një formë të ndryshme në elemente që nuk ndryshojnë karakterin dallues të markës në formën në të cilën është regjistruar në një nga vendet e Bashkimit nuk do të sjellë pavlefshmëri të regjistrimit dhe nuk do të zvogëlojë mbrojtjen e dhënë për markën.

(3) Përdorimi i njëkohshëm i së njëjtës markë në mallra identike ose të ngjashme nga ndërmarrjet industriale ose tregtare që konsiderohen si bashkëpronar të markës, sipas dispozitave të legjislacionit të brendshëm të vendit ku kërkohet mbrojtja nuk do të pengojë regjistrimin ose të zvogëlojë në asnjë mënyrë mbrojtjen e dhënë ndaj markës në fjalë në asnjë vend të Unionit, me kusht që një përdorim i tillë të mos çojë në mashtrim të publikut dhe të mos jetë në kundërshtim me interesin publik.

D. — Asnjë tregues ose përmendje e patentës, modelit të përdorimit, regjistrimit të markës tregtare ose depozitimit të dizenjos industriale nuk do të kërkohet për mallrat si kusht për njohjen e së drejtës për mbrojtje.

Neni 5bis

[*Të gjitha të drejtat e pronësisë industriale:* Periudha e mospagimit për pagesën e tarifave për mbajtjen e të drejtave; Patentat: Rivendosja e të drejtave]

(1) Për pagesën e tarifave të përcaktuara për ruajtjen e të drejtave të pronësisë industriale, lejohet një periudhë mospagimi jo më pak se gjashtë muaj, me kusht që, nëse legjislacioni vendas e parashikon, të paguhet një tarifë shtesë.

(2) Vendet e Unionit do të kenë të drejtë të parashikojnë rivendosjen e të drejtave për patentat që kanë skaduar për shkak të mospagesës së tarifave.

Neni 5ter

[*Patentat:* Pajisjet e patentuara që përbëjnë pjesë të anijeve, avionëve ose automjeteve tokësore]

Në asnjë vend të Unionit, për sa vijon nuk do të konsiderohet si shkelje e të drejtave të një pronari patente:

1. përdorimi në bordin e anijeve të vendeve të tjera të Unionit, i pajisjeve që përbëjnë objektin e patentës së tij në trupin e anijes, në makineri, mjete, mekanizma dhe pajisje të tjera, kur anije të tilla hyjnë përkohësisht ose aksidentalisht në ujërat e vendit në fjalë, me kusht që pajisje të tilla të përdoren atje ekskluzivisht për nevojat e anijes;
2. përdorimi i pajisjeve që përbëjnë objektin e patentës në ndërtimin ose funksionimin e avionëve ose mjeteve tokësore të vendeve të tjera të Unionit, ose aksesorëve të këtyre avionëve ose mjeteve tokësore, kur këta avionë ose mjete tokësore hyjnë përkohësisht ose aksidentalisht në vendin e përmendur.

Neni 5^{quater}

[*Patentat:* Importimi i produkteve të prodhuara nga një proces i patentuar në vendin importues]

Kur një produkt importohet në një vend të Unionit ku ekziston një patentë që mbron procesin e prodhimit të produktit në fjalë, pronari i patentes do të ketë të gjitha të drejtat, në lidhje me produktin e importuar, që i akordohen nga legjislacioni i vendit të importimit, në bazë të patentës së procesit, në lidhje me produktet e prodhuara në atë vend.

Neni 5^{quinquies}

[*Dizenjot industriale*]

Dizajnet industriale do të mbrohen në të gjitha vendet e Bashkimit

Neni 6

[*Markat:* Kushtet e Regjistrimit; Pavarësia e mbrojtjes së të njëjtës markë në vende të ndryshme]

(1) Kushtet për paraqitjen dhe regjistrimin e markave tregtare do të përcaktohen në çdo vend të Unionit me legjislacionin e tij të brendshëm.

(2) Një aplikim për regjistrimin e një marke të paraqitur nga një shtetas i një vendi të Unionit në asnjë vend të Unionit nuk mund të refuzohet, as regjistrimi nuk mund të zhvlerësohet, me arsyetimin se depozitimi, regjistrimi ose rinovimi, nuk është kryer në vendin e origjinës.

(3) Një markë e regjistruar siç duhet në një vend të Unionit do të konsiderohet si e pavarur nga markat e regjistruara në vendet e tjera të Unionit, duke përfshirë vendin e origjinës.

Neni 6[bis]

[*Markat:* Markat e mirënjohura]

(1) Vendet e Unionit marrin përsipër, sipas detyrës zyrtare, nëse legjislacioni i tyre e lejon, ose me kërkesë të një pale të interesuar, të refuzojnë ose të anulojnë regjistrimin dhe të ndalojnë përdorimin e një marke tregtare që përbën një riprodhim, imitim, ose një përkthim të një marke të konsideruar të mirënjohur nga autoriteti kompetent i vendit të regjistrimit ose përdorimit në atë vend dhe që sjell konfuzion. Këto dispozita do të zbatohen gjithashtu kur pjesa thelbësore e markës përbën një riprodhim të ndonjë marke të tillë të mirënjohur ose një imitim që mund të krijojë konfuzion me të.

(2) Për të kërkuar heqjen e një marke të tillë duhet një periudhë prej së paku pesë vjet nga data e regjistrimit. Vendet e Unionit mund të parashikojnë një periudhë brenda së cilës duhet të kërkohet ndalimi i përdorimit.

(3) Nuk do të caktohet asnjë afat kohor për të kërkuar anulimin ose ndalimin e përdorimit të markave të regjistruara ose të përdorura me keqbesim.

Neni 6[ter]

[*Markat:* Ndalimet në lidhje me emblemat shtetërore, shenjat zyrtare dhe emblemat e organizatave ndërqeveritare]

(1)

(a)

Vendet e Unionit bien dakord të refuzojnë ose të anullojnë regjistrimin dhe të ndalojnë me masat e duhura përdorimin pa autorizim nga autoritetet kompetente, qoftë si marka tregtare ose si elemente të markave tregtare, të stemave, flamujve dhe të emblemave të tjera shtetërore të vendeve të Unionit, shenjave zyrtare dhe shenjave për kontroll dhe garanci miratuar prej tyre, dhe çdo imitim nga pikëpamja heraldike

(b) Dispozitat e nënparagrafit (a), më sipër, do të zbatohen në mënyrë të barabartë për stemat e armatimit, flamujt, emblemat e tjera, emrave (të plotë ose të shkurtuar), të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare në të cilat një ose më shumë vende të Unionit janë anëtarë, me përjashtim të stemave, flamujt, emblemat e tjera, emrat (të plotë ose të shkurtuar), që tashmë janë objekt i marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi, që synojnë të garantojnë mbrojtjen e tyre.

(c) Asnjë vendi i Unionit nuk do t'i kërkohet të zbatojë dispozitat e nënparagrafit (b), më sipër, në dëm të pronarëve të të drejtave të fituara me mirëbesim përpara hyrjes në fuqi, në atë vend, të kësaj Konvente. Vendeve të Unionit nuk u kërkohet të zbatojnë dispozitat në fjalë kur përdorimi ose regjistrimi i përmendur në nënparagrafin (a), më sipër, nuk është i një natyre të tillë që t'i sugjerojë publikut se ekziston një lidhje midis organizatës në fjalë dhe stemave zyrtare, flamujve, emblemave, shkurtesat dhe emrat, ose nëse përdorimi ose regjistrimi i tillë ndoshta nuk është i një natyre të tillë që të mashtrojë publikun për ekzistencën e një lidhjeje midis përdoruesit dhe organizatës.

(2) Ndalimi i përdorimit të shenjave zyrtare dhe shenjave dalluese që tregojnë kontroll dhe garanci zbatohet vetëm në rastet kur markat në të cilat janë inkorporuar synohen të përdoren për mallra të të njëjtit lloj ose të një lloji të ngjashëm.

(3)

(a) Për zbatimin e këtyre dispozitave, vendet e Unionit bien dakord ti dorëzojnë njëri tjetrit, nëpërmjet ndërmjetësimit të Byrosë Ndërkombëtare, listën e stemave shtetërore dhe shenjave zyrtare dhe shenjave për kontroll dhe garanci, që ata dëshirojnë ose do të donin, ti vendosnin tërësisht ose në kufij të caktuar nën mbrojtjen e këtij Neni, si edhe çdo ndryshim i ardhshëm i kryer në këtë listë. Çdo vend i Unionit do të vërë në dispozicion të publikut listat e dorëzuara në këtë mënyrë. Megjithatë, një dorëzim i tillë nuk është i detyrueshëm në lidhje me flamujt e shteteve.

(b) Dispozitat e nënparagrafit (b) të paragrafit (1) të kësaj Neni do të zbatohen vetëm mbi stemat, flamujt, simbole e tjera dhe emërtimet e organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare që këto të fundit ua kanë komunikuar vendeve të Unionit me ndërmjetësimin e Byrosë Ndërkombëtare.

(4) Çdo vend i Unionit, brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore nga marrja e njoftimit, mund t'i transmetojë kundërshtimet e tij, nëse ka, shtetit ose organizatës ndërqeveritare ndërkombëtare në fjalë nëpërmjet ndërmjetësimit të Byrosë Ndërkombëtare.

(5) Në rastin e flamujve shtetërorë, masat e përcaktuara në paragrafin (1), më sipër, do të zbatohen vetëm për markat e regjistruara pas 6 nëntorit 1925.

(6) Për sa i përket stemave shtetërore të ndryshme, të shenjave zyrtare të vendeve të Unionit, dhe në rastin e stemave zyrtare, flamujve, stemave të tjera, shkurtesave dhe emërtimeve të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, këto dispozitat do të zbatohen vetëm për markat e regjistruara më shumë se dy muaj pas pranimit të njoftimit të parashikuar në paragrafin (3), më sipër.

(7) Në rastet e keqbesimit, vendet do të kenë të drejtë të anulojnë edhe ato marka që përmbajnë stema, vula dhe shenja zyrtare shtetërore, të cilat janë regjistruar përpara datës 6 nëntor 1925.

(8) Shtetasit e çdo vendi që janë të autorizuar të përdorin stemat, shenjat dhe vulat shtetërore të vendit të tyre mund t'i përdorin ato edhe nëse janë të ngjashme me ato të një vendi tjetër.

(9) Vendet e Unionit marrin përsipër të ndalojnë përdorimin e paautorizuar në tregti të simboleve shtetërore të vendeve të Unionit, kur përdorimi ka natyre konfuzioni për origjinën e produktit.

(10)Dispozitat e mësipërme nuk do t'i pengojnë vendet të ushtrojnë të drejtën e dhënë në paragrafin (3) të nenit 6 quinquies, Seksioni B, për të refuzuar ose për të shfuqizuar regjistrimin e markave që përfshijnë, pa autorizim, stema, flamuj, emblema të tjera shtetërore ose shenjat zyrtare dhe shenjat dalluese të miratuara nga një vend i Unionit, si dhe shenjat dalluese të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare të përmendura në paragrafin (1) më sipër.

Neni 6^{quater}

[*Markat:* Transferimi i pronësisë së markave]

(1) Kur, në përputhje me ligjin e një vendi të Unionit, transferimi i një marke është i vlefshëm vetëm nëse bëhet në të njëjtën kohë me transferimin e biznesit ose të emrit të mirë të cilit i përket marka, do të mjaftojë për njohjen e një vlefshmërie të tillë që pjesa e biznesit ose emri i mirë që ndodhet në atë vend t'i transferohet përfituesit, së bashku me të drejtën ekskluzive për të prodhuar në vendin në fjalë, ose për të shitur në të, mallrat që mbajnë markën e transferuar.

(2) Dispozita e mësipërme nuk u imponon vendeve të Unionit asnjë detyrim për të konsideruar të vlefshëm transferimin e një marke, përdorimi i së cilës nga marrësi në fakt, do të sillte konfuzion tek publiku, veçanërisht në lidhje me origjinën, natyrën ose cilësitë thelbësore të mallrave për të cilat aplikohet marka.

Neni 6^{quinquies}

[Markat: Mbrojtja e markave që janë regjistruar në një shtet të Unionit, në vendet e tjera të Unionit]

A.—

(1) E

Çdo markë tregtare e regjistruar siç duhet në vendin e origjinës do të pranohet për paraqitje dhe do të mbrohet siç e tillë në vendet e tjera të Unionit, duke iu nënshtruar parashikimeve të këtij Neni. Këto vende, përpara se të vazhdojnë regjistrimin përfundimtar, mund të kërkojnë paraqitjen e një certifikate regjistrimi në vendin e origjinës, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Nuk kërkohet asnjë vërtetim për këtë certifikatë.

(2) Vendi i origjinës do të konsiderohet vendi i Unonit ku aplikanti ka një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare, ose, nëse ai nuk ka një ndërmarrje të tillë brenda Unionit, vendi i Unionit ku ai ka vendbanimin e tij , ose, nëse ai nuk ka vendbanim brenda Unionut, por është shtetas i një vendi të Unionit, shteti i të cilit ai është shtetas.

B. — Markat tregtare të përfshira në këtë Nen nuk mund të refuzohen dhe as të anulohen, përveç në rastet e mëposhtme:

1. kur ato janë të një natyre të tillë që cenojnë të drejtat e fituara nga palët e treta në vendin ku kërkohet mbrojtja;
2. kur ato nuk kanë asnjë karakter dallues ose përbëhen ekskluzivisht nga shenja ose tregues që mund të shërbejnë, në tregti, për të përcaktuar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin e synuar, vlerën, vendin e origjinës, të mallrave ose kohën e prodhimit, ose janë bërë të zakonshme në gjuhën aktuale ose në praktikat e mirëbesimit dhe të vendosura të tregtisë së vendit ku kërkohet mbrojtja;
3. kur janë në kundërshtim me moralin ose rendin publik dhe në veçanti të një natyre të tillë që konfuzojnë publikun. Kuptohet që një markë nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me rendin publik për të vetmen arsye se nuk është në përputhje me një dispozitë të legjislacionit për markat, përveç nëse një dispozitë e tillë ka të bëjë me rendin publik..

Megjithatë, kjo dispozitë i nënshtrohet zbatimit të Nenit 10bis.

C.—

(1) Për të përcaktuar nëse një markë është e përshtatshme për mbrojtje, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat faktike, veçanërisht kohëzgjatja e përdorimit të markës.

(2) Asnjë markë tregtare nuk do të refuzohet në vendet e tjera të Unionit për të vetmen arsye se ajo ndryshon nga marka e mbrojtur në vendin e origjinës vetëm në lidhje me elementet që nuk ndryshojnë karakterin e saj dallues dhe nuk cenojnë identitetin e saj në formën në të cilën është regjistruar në vendin e origjinës në fjalë

D. — Asnjë person nuk mund të përfitojë nga dispozitat e kësaj Neni nëse marka për të cilën ai pretendon mbrojtjen nuk është e regjistruar në vendin e origjinës.

E. — Megjithatë, në asnjë rast rinovimi i regjistrimit të markës në vendin e origjinës nuk përfshin detyrimin për të rinovuar regjistrimin në vendet e tjera të Unionit në të cilat marka është regjistruar.

F. — Përfitimi i prioritetit mbetet i paprekur për aplikimet për regjistrimin e markave të paraqitura brenda afatit të përcaktuar nga Neni 4, edhe nëse regjistrimi në vendin e origjinës kryhet pas përfundimit të kësaj periudhe.

Neni 6^{sexies}

[*Markat: Markat e Shërbimit*]

Vendet e Unionit marrin përsipër të mbrojnë markat e shërbimit. Atyre nuk u kërkohet të parashikojnë regjistrimin e këtyre markave.

Neni 6^{septies}

[*Markat:* Regjistrimi në emër të agjentit ose përfaqësuesit të pronarit pa autorizimin e këtij të fundit]

(1) Nëse agjenti ose përfaqësuesi i personit që është pronar i një marke në një nga shtetet e Unionit aplikon, pa autorizimin e pronarit, për regjistrimin e markës në emër të tij, në një ose më shumë shtete të Unionit, pronari ka të drejtë të kundërshtojë regjistrimin e aplikimit ose të kërkojë anulimin e tij ose, nëse ligji i vendit e lejon këtë, caktimin në favor të tij të regjistrimit në fjalë, përveç rasteve kur ky agjent ose përfaqësues e justifikon veprimin e tij.

(2) Pronari i markës, në përputhje me dispozitat e paragrafit (1), më lart, ka të drejtë të kundërshtojë përdorimin e markës së tij nga agjenti ose përfaqësuesi i tij nëse ai nuk e ka autorizuar një përdorim të tillë.

(3) Legjislacioni i brendshëm mund të parashikojë një afat kohor brenda të cilit pronari i një marke duhet të ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë Nen.

Neni 7
[*Markat:* Natyra e Mallrave për të cilat është aplikuar Marka]

Natyra e mallrave për të cilat do të aplikohet një markë tregtare nuk përbën në asnjë rast pengesë për regjistrimin e markës.

Neni 7bis
[*Markat:* Markat Kolektive]

(1) Shtetet e Unionit marrin përsipër të pranojnë për aplikim dhe të mbrojnë markat kolektive që u përkasin shoqatave, ekzistenca e të cilave nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të origjinës, edhe nëse këto shoqata nuk posedojnë një ndërmarrje industriale ose tregtare.

(2) Çdo vend do të gjykojë kushtet e veçanta në të cilat mbrohet një markë kolektive dhe mund të refuzojë mbrojtjen nëse marka është në kundërshtim me interesin publik.

(3) Megjithatë, mbrojtja e këtyre markave nuk do t'i refuzohet asnjë shoqate, ekzistenca e së cilës nuk është në kundërshtim me ligjin e vendit të origjinës, me arsyetimin se një shoqatë e tillë nuk është themeluar në vendin ku kërkohet mbrojtja ose nuk është krijuar sipas ligjit të këtij vendi.

Neni 8
[*Emrat Tregëtare*]

Emri tregtar mbrohet në të gjitha shtetet e Unionit pa detyrimin për aplikim ose regjistrim, pavarësisht nëse është apo jo pjesë e një marke tregtare.

Neni 9
[*Markat, Emrat Tregtarë:* Konfiskimi, në Import, etj.,
i mallrave që mbajnë në mënyrë të paligjshme një
markë ose emër tregtar]

(1) Të gjitha mallrat që mbajnë në mënyrë të paligjshme një markë tregtare ose emër tregtar do të konfiskohen (sekuestohen) gjatë importit në ato shtete të Unionit ku kjo markë ose ky emër tregtar ka të drejtën e mbrojtjes ligjore.

(2) Konfiskimi do të kryhet gjithashtu në vendin ku ka ndodhur lëshimi i paligjshëm ose në vendin në të cilin janë importuar mallrat.

(3) Konfiskimi bëhet me kërkesën e prokurorit publik, të ndonjë organi tjetër kompetent, ose të ndonjë pale të interesuar, qoftë person fizik apo juridik, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të secilit shtet.

(4) Autoritetet nuk janë të detyruara të bëjnë konfiskim të mallit në transit.

(5) Nëse legjislacioni i një vendi nuk e lejon konfiskimin gjatë importit, konfiskimi zëvendësohet me ndalimin e importit ose me konfiskim brenda vendit.

(6) Nëse legjislacioni i një vendi nuk lejon as konfiskimin e importit, as ndalimin e importit ose konfiskimin brenda vendit, atëherë, derisa legjislacioni të modifikohet në përputhje me rrethanat, këto masa do të zëvendësohen me veprimet dhe mjetet juridike të disponueshme në raste të tilla për shtetasve sipas ligjit të këtij vendi.

Neni 10
[*Indikacione të rreme:* Konfiskimi, në import, etj., i mallrave
që përmbajnë indikacion të rremë për prejardhjen e tyre ose
identitetin e prodhuesit]

(1) Dispozitat e Nenit të mësipërm do të zbatohen në rastet e përdorimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të indikacionit të rremë për prejardhjen e mallit ose identitetit të prodhuesit, fabrikuesit ose tregtarit.

(2) Çdo prodhues, fabrikues ose tregtar, qoftë person fizik ose juridik, i angazhuar në prodhimin, fabrikimin ose tregtimin e mallrave të tilla dhe i vendosur në vendin e treguar gabimisht si prejardhje, ose në rajonin ku ndodhet ky vend, ose në vendin ku përdoret indikacioni i rremë i prejardhjes, në çdo rast do të konsiderohet palë e interesuar.

Neni 10bis

[*Konkurrenca e pandershme*]

(1) Vendet e Unionit janë të detyruara t'u sigurojnë shtetasve të këtyre vendeve mbrojtje efektive kundër konkurrencës së pandershme.

(2) Çdo veprim i konkurrencës në kundërshtim me praktikat e ndershme në çështjet industriale ose tregtare përbën një akt të konkurrencës së pandershme.

(3) Veçanërisht duhet të ndalohen:

1. të gjitha veprimet e një natyre të tillë që krijojnë konfuzion me çfarëdo mënyre me themelimin, mallrat ose aktivitetet industriale ose tregtare të një konkurrenti;
2. pretendime të rreme gjatë tregtisë të një natyre të tillë që diskreditojnë ndërmarrjen, mallrat ose aktivitetet industriale ose tregtare të një konkurrenti;
3. indikacione ose pretendime, përdorimi i të cilave gjatë tregtisë mund të mashtrojë publikun në lidhje me natyrën, procesin e prodhimit, karakteristikat, përshtatshmërinë për qëllimin e tyre ose sasinë e mallrave.

Neni 10ter

[*Markat, Emrat tregtarë, Indikacionet e rreme, Konkurrencë e pandershme:* mjete juridike, e drejta për të paditur]

(1) Vendet e Unionit marrin përsipër t'u sigurojnë shtetasve të vendeve të tjera të Unionit mjete juridike të përshtatshme për të eleminuar në mënyrë efektive të gjitha aktet e përmendura në Nenin 9, 10 dhe 10bis.

(2) Gjithashtu, ata marrin përsipër të sigurojnë masa për të lejuar federatat dhe shoqatat që përfaqësojnë industrialistët, fabrikuesit ose tregtarët e interesuar, me kusht që ekzistenca e këtyre federatave dhe shoqatave të mos jetë në kundërshtim me ligjet e vendeve të tyre, të ndërmarrin veprime në gjykata ose para autoriteteve administrative, me qëllim eleminimin e akteve të përmendura në Nenin 9, 10 dhe 10bis, për aq sa ligji i vendit në të cilin kërkohet mbrojtja lejon një veprim të tillë nga federatat dhe shoqatat e atij vendi.

Neni 11

[*Shpikjet, Modelet e përdorimit, Modelet industriale, Markat:* Mbrojtje e përkohshme në disa ekspozita ndërkombëtare]

(1) Shtetet e Unionit, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, do t'u japin mbrojtje të përkohshme shpikjeve të patentueshme, modeleve të përdorimit, modeleve industriale dhe markave tregtare, në lidhje me mallrat e ekspozuara në ekspozitat ndërkombëtare zyrtare ose jo të mbajtura në territorin e ndonjërit prej tyre.

(2) Një mbrojtje e tillë e përkohshme nuk do të zgjasë afatet e parashikuara nga Neni 4. Nëse, më vonë, thirret e drejta e prioritetit, autoritetet e çdo vendi mund të parashikojnë që afati të fillojë nga data e vendosjes së artikujve në ekspozitë.

(3) Çdo vend mund të kërkojë, si dëshmi të vërtetësisë të artikullit të ekspozuar dhe të datës së paraqitjes së tij, prova të tilla dokumentuese që i konsideron të nevojshme.

Neni 12

[Shërbime të Posaçme Kombëtare të Pronësisë Industriale]

(1) Çdo shtet i Unionit merr përsipër të krijojë një shërbim të posaçëm për pronësisë industriale (drejtori) dhe një zyrë qendrore për komunikimin me publikun për patentat, modelet e përdorimit, modelet industriale dhe markat tregtare.

(2) Ky shërbim boton revistë zyrtare periodike. Ai do të publikojë rregullisht:

(a) emrat e pronarëve të patentave të dhëna, me një përcaktim të shkurtër të shpikjeve të patentuara;

(b) riprodhimet e markave të regjistruara.

Neni 13
[Kuvendi i Unionit]

(1)

(a) Unioni do të ketë një Kuvend të përbërë nga ato shtete të Unionit që janë të lidhura nga Nenet 13 deri në 17.

*(b)*Qeveria e çdo shteti do të përfaqësohet nga një delegat, të cilin mund ta ndihmojnë delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të tjerë.

(c) Shpenzimet e secilit delegacion do të përballohen nga Qeveria që e ka caktuar atë.

(2)

(a) Kuvendi:

(i) merret me të gjitha çështjet në lidhje me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit dhe zbatimin e kësaj Konvente;

(ii) jep udhëzime në lidhje me përgatitjen për konferencave për rishikim të Byrosë Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale (në tekstin këtu e emërtuar si "Byroja Ndërkombëtare") referuar Konventës për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (më tej e quajtur "Organizata"), duke u marrë parasysh vërejtjet e bëra nga ato vende të Unionit që nuk janë të përfshira nga Neni 13 deri në 17;

(iii) shqyrton dhe miraton raportet dhe aktivitetet e Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës në lidhje me Unionin dhe i jep atij të gjitha udhëzimet e nevojshme në lidhje me çështjet brenda kompetencës së Unionit;

(iv) zgjedh anëtarët e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit;

(v) shqyrton dhe miraton raportet dhe aktivitete e Këshillit të tij ekzekutiv dhe i jep udhëzime;

(vi) përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit dhe llogaritë e tij përfundimtare;

(vii) miraton rregulloret financiare të Unionit;

(viii) krijon këshille ekspertësh dhe grupe pune duke e parë të aryseshme për të arritur objektivat e Unionit;

(ix) vendos cilat vende që nuk janë anëtarë të Unionit dhe cilat organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij në cilësinë e vëzhguesit;

(x) miraton ndryshimet në nenet nga 13 në 17;

(xi) ndërmerr gjithçka tjetër që është në të mirë të realizimit të detyrave të Unionit;

(xii) kryen funksione të tjera që janë të përshtatshme sipas kësaj Konvente;

(xiii) në varësi të pranimit të tij, të ushtrojë të drejtat që i janë dhënë në Konventën që themelon Organizatën.

(b) për çështje për të cilat janë të interesuar njësoj edhe unionet tjera të cilat administrohen nga Organizata, Kuvendi vendos të marrë vendim pasi të marrë mendim nga Këshilli koordinues i Organizatës.

(3)

(a) Në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (b), një delegat mund të përfaqësojë vetëm një shtet.

(b) Shtetet e Unionit të cilat janë grupuar sipas kushteve të një marrëveshjeje të veçantë në një zyrë të përbashkët që ka për secilën prej tyre karakterin e një shërbimi të posaçëm kombëtar të pronësisë industriale, siç përmendet në Nenin 12, mund të përfaqësohen bashkë gjatë diskutimeve nga njëri prej tyre.

(4)

(a) Çdo vend anëtar i Kuvendit do të ketë një votë.

(b) Gjysma e vendeve anëtare të Kuvendit do të përbëjnë kuorumin.

(c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (b), nëse, në çdo seancë, numri i vendeve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por i barabartë ose më i madh se një e treta e vendeve anëtare të Kuvendit, Kuvendi mund të bëjë vendimet por, me përjashtim të vendimeve në lidhje me procedurën e tij, të gjitha këto vendime hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e parashtruara në vijim.

Byroja Ndërkombëtare do t'ua komunikojë vendimet në fjalë vendeve anëtare të Kuvendit që nuk ishin të përfaqësuara dhe do t'i ftojë ata të shprehin me shkrim votën ose abstenimin e tyre brenda një periudhe tre mujore nga data e komunikimit. Nëse, në përfundimin e këtij afati numri i vendeve që kanë shprehur në këtë mënyrë votën ose abstenimin e tyre arrin numrin e vendeve që mungonin për arritjen e kuorumit në vetë seancën, vendimet do të hyjnë në fuqi me kusht që njëkohësisht të jetë arritur shumica e nevojshme.

(d) Në përputhje me dispozitat e Nenit 17(2), vendimet e Kuvendit kërkojnë dy të tretat e votave të dhëna.

(e) Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

(5) *(a)* Në përputhje me dispozitat e nënparagrafit (b), një delegat mund të votojë vetëm në emër të një vendi.

(b) Vendet e Unionit të përmendura në paragrafin (3) (b), si rregull i përgjithshëm do të përpiqen të dërgojnë delegacionet e tyre në seancat e Kuvendit. Megjithatë, nëse, për arsye të jashtëzakonshme, një vend i tillë nuk mund të dërgojë delegacionin e tij, ai mund t'i japë delegacionit të një vendi tjetër kompetencën për të votuar në emër të tij, me kusht që secili delegacion të mund të votojë me përfaqësues vetëm për një vend. Kjo fuqi për të votuar jepet në një dokument të nënshkruar nga kreu i shtetit ose ministri kompetent.

(6) Vendet e Unionit që nuk janë anëtare të Kuvendit do të pranohen në mbledhjet e këtij të fundit si vëzhgues.

(7)

(a) Kuvendi do të mblidhet një herë në çdo dy vjet në seancë të zakonshme nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Kuvendi i Përgjithshëm i Organizatës.

(b) Kuvendi do të mblidhet në seancë të jashtëzakonshme nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesë të Këshillit Ekzekutiv ose me kërkesë të një të katërtës së vendeve anëtare të Kuvendit.

(8) Kuvendi miraton rregulloren e vet të punës.

Neni 14
[Këshilli Ekzekutiv]

(1) Kuvendi ka Këshillin Ekzekutiv

(2) .

(a) Këshilli Ekzekutiv është formuar nga vende që zgjedhen nga Kuvendi nga radhët e vendeve anëtare të Kuvendit. Për më tepër, vendi në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, sipas dispozitave të Nenit 16(7)(b), do të ketë një vend ex officio në Këshill.

(b) Qeveria e çdo vendi anëtar të Këshilli Ekzekutiv do të përfaqësohet nga një përfaqësues, i cili mund të ndihmohet nga zëvendës, këshilltarë dhe ekspertë alternativë.

(c) Shpenzimet e secilit delegacion do të përballohen nga Qeveria që e ka caktuar atë.

(3) Numri i vendeve anëtare të Këshillit ekzekutiv është i barabartë me një të katërtën e vendeve anëtare të Kuvendit. Gjatë llogaritjes së ulëseve që duhet të caktohen, mbetjet pas pjesëtimit me katër pjesë nuk merren parasysh.

(4) Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv, Kuvendi do t'i kushtojë vëmendje një shpërndarjeje të rregullt gjeografike dhe domosdoshmërisë që vendet palë në Marrëveshjet e veçanta të krijuara në lidhje me Unionin të jenë ndër vendet që përbëjnë Këshillin Ekzekutiv.

(5)

(a) Anëtarët e Këshillit ekzekutiv do të kryejnë detyrimet e tyre nga hapja e mbledhjes së Kuvendit për të cilat janë zgjedhur deri në fundin e seancës së ardhshme të rregullt të Kuvendit.

(b) Anëtarët e Këshillit ekzekutiv mund të rizgjidhen sërish, por më së shumti dy të tretat ndër ta (prej tyre).

(c) Kuvendi i përcakton mënyrat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së mundshme të anëtarëve të Këshillit ekzekutiv.

(6)

(a) Këshilli ekzekutiv:

(i) Përgatit draft të rendit të ditës së Kuvendit;

(ii) I dorëzon Kuvendit propozime në lidhje me draftet e programeve dhe buxhetin trevjeçar të Unionit që i ka përgatitur drejtori i përgjithshëm;

(iii) *[e hequr]*

(iv) I paraqet Kuvendit, me argumentimet e duhura, raportet periodike të Drejtorit të Përgjithshëm dhe raportet vjetore të auditimit mbi llogaritë;

(v) Ndërmerr të gjitha masat e duhura që drejtori i përgjithshëm ta realizojë programin e Unionit në përputhje me vendimet e Kuvendit dhe duke mbajtur llogari për rrethanat e krijuara midis dy seancave të rregullta të këtij Kuvendi;

(vi) të kryejë funksione të tjera që i janë caktuar sipas kësaj Konvente.

(b) Për çështje për të cilat janë të interesuar edhe unionet tjerë që i administron Organizata, Këshilli ekzekutiv vendos pasi që të njihet me mendimin e Këshillit koordinues të Organizatës.

(7)

(a) Këshilli ekzekutiv mblidhet në seancë të rregullt një herë në vit, me ftesë të drejtorit të përgjithshëm, mundësisht në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend si edhe Këshilli koordinues i Organizatës.

(b) Këshilli ekzekutiv mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me ftesë të drejtorit të përgjithshëm, qoftë me iniciativë të tij, qoftë me kërkesë të kryetarit të tij, ose një të katërtës të anëtarëve të tij.

(8)

(a) Çdo vend anëtar i Komitetit Ekzekutiv disponon një votë.

(b) Kuorumin e përbën gjysma e vendeve anëtare të Këshillit ekzekutiv.

(c) Vendimet do të merren me shumicë të thjeshtë të votave të dhëna.

(d) Abstenimet nuk do të konsiderohen si vota.

(e) Një përfaqësues mund të përfaqësojë vetëm një vend dhe mund të votoj vetëm në emër të tij.

(9) Vendet e Unionit që nuk janë anëtarë të Këshillit ekzekutiv, marrin pjesë në takimet e tij në cilësinë e vëzhguesit.

(10) Këshilli (Komiteti) ekzekutiv miraton rregulloren e tij.

Neni 15
[Byroja Ndërkombëtare]

(1) *(a)*

Detyrat administrative në lidhje me Unionin i kryen Byroja Ndërkombëtare, e cila është vazhdimësi e Byrosë së Unionit të bashkuar me Byronë e Unionit të krijuar nga Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike.

(b) Byroja ndërkombëtare në veçanti kryen punë të sekretariatit në organe të ndryshme të Unionit.

(c) Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës do të jetë shefi ekzekutiv i Unionit dhe do të përfaqësojë Unionin.

(2) Byroja Ndërkombëtare mbledh dhe publikon informacione në lidhje me mbrojtjen e pronësisë industriale. Çdo vend i Unionit do t'i komunikojë menjëherë Byrosë Ndërkombëtare të gjitha ligjet e reja dhe dokumentet zyrtare në lidhje me mbrojtjen e pronësisë industriale. Për më tepër, ai do t'i sigurojë Byrosë Ndërkombëtare të gjitha botimet e shërbimeve të veta në fushën e pronësisë industriale që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mbrojtjen e pronësisë industriale, të cilat Byroja Ndërkombëtare mund t'i konsiderojë të dobishme në punën e saj.

(3) Byroja ndërkombëtare boton revistë mujore.

(4) Byroja Ndërkombëtare, me kërkesë, do t'i japë çdo vendi të Unionit informacion për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronësisë industriale.

(5) Byroja ndërkombëtare merret me studime dhe ofron shërbime të dedikuara për lehtësimin e mbrojtjes së pronësisë industriale.

(6) Drejtori i përgjithshëm dhe çdo anëtar i caktuar prej tij do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të Këshillit Ekzekutiv dhe të çdo komisioni tjetër të ekspertëve apo grupi pune. Drejtori i Përgjithshëm, ose një anëtar i personelit i caktuar prej tij, do të jetë ex officio sekretar i këtyre organeve.

(7)

(a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Kuvendit dhe në bashkëpunim me Këshillin Ekzekutiv, do të përgatitë konferencat për rishikim të dispozitave të Konventës, përveç neneve 13 deri në 17.

(b) Për përgatitjen e konferencës për rishikim, Byroja ndërkombëtare mund të këshillohet me organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare.

(c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet në këto konferenca.

(8) Byroja Ndërkombëtare do të kryejë çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 16
[Financat]

(1)

(a) Unioni ka buxhetin e tij.

(b) Buxheti i Unionit përfshin të ardhura dhe shpenzime personale të Unionit, kontribut i saj për buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta të Unionit, si edhe, në rast të nevojës, shumë e caktuar e lënë në dispozicion për buxhetin e Konferencës së Organizatës.

(c) Si shpenzime të përbashkëta të Unionit konsiderohen shpenzimet që nuk i takojnë ekskluzivisht Unionit, por gjithashtu një apo më shumë unioneve që administrohen nga Organizata. Pjesëmarrja e Unionit në këto shpenzime të përbashkëta do të jetë në përpjesëtim me interesin që Unioni ka në to.

(2) Buxheti i Unionit do të krijohet duke marrë parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e unioneve të tjera të administruara nga Organizata.

(3) Buxheti i Unionit financohet nga burimet në vijim:

(i) Kontributi i vendeve të Unionit;

(ii) Taksa dhe tarifa për shërbimet e kryera nga Byroja ndërkombëtare në emër të Unionit;

(iii) Të ardhura nga shitja e botimeve të Byrosë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Unionin dhe të drejtat që rrjedhin nga këto botime;

(iv) Dhurata, donacione dhe subvencione;

(v) qiratë, interesat dhe të ardhurat e tjera të ndryshme.

(4)

(a) Për të përcaktuar pjesën e kontributit për buxhetin e secilit vend të Unionit, ai vendoset në një klasë dhe i kryen kontributet e tij vjetore në bazë të disa njësive të përcaktuara si në vijim:

Klasa I	25
Klasa II	20
Klasa III	15
Klasa IV	10
Klasa V	5
Klasa VI	3
Klasa VII	1

(b) Nëse nuk e ka bërë këtë më herët, çdo vend do të tregojë, njëkohësisht me depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit, klasën së cilës dëshiron t'i përkasë. Çdo vend mund të ndryshojë klasë. Nëse zgjedh një klasë më të ulët, vendi duhet t'ia njoftojë Kuvendit një ndryshim të tillë në një nga seancat e zakonshme. Çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi në fillim të vitit kalendarik

pas seancës në fjalë.

(c) Kontributi vjetor i çdo vendi do të jetë një shumë në të njëjtën proporcion me shumën totale që do të kontribuohet në buxhetin e Bashkimit nga të gjitha vendet, pasi numri i njësive të tij është me totalin e njësive të të gjitha vendeve kontribuuese.

(d) Kontributet do të paguhen më 1 janar të çdo viti.

(e) Vendi që është me vonesë në pagesën e kontributeve të tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit në të cilin është anëtar, në qoftë se shuma e mbetur e papaguar është e barabartë ose më e madhe se kontributi që ka borxh për dy vite të plota të kaluara. Megjithatë, ai vend mund të autorizohet të mbajë të drejtën e votës në kuadër të atij organi për aq kohë sa ky organ konsideron se vonesa rezulton nga rrethana të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

(f) Nëse buxheti nuk miratohet përpara fillimit të periudhes të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit të kaluar, siç parashikohet në rregulloret financiare.

(5) Shuma e taksave dhe tarifave për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin do të përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe do t'i raportohet Kuvendit dhe Këshillit Ekzekutiv.

(6)

(a) Unioni do të ketë një fond kapitali qarkullues i cili do të formohet nga pagesat e vetme të bëra nga çdo vend i Unionit. Nëse fondi bëhet i pamjaftueshëm, Kuvendi vendos për rritjen e tij.

(b) Shuma e pagesës fillestare të çdo vendi në fondin e përmendur ose rritja e saj është proporcionale me kontributin e atij vendi për vitin gjatë të cilit krijohet fondi ose kur vendoset për rritjen e tij.

(c) Kuvendi përshkruan raportin dhe mënyrat e pagesës me propozim të drejtorit të përgjithshëm dhe sipas raportit të pranuar nga këshilli koordinues i Organizatës.

(7)

(a) Në marrëveshjen për selinë të lidhur me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, do të parashikohet që, sa herë që fondi i kapitalit qarkullues është i pamjaftueshëm, ky vend do të japë paradhënie. Shuma e këtyre paradhënieve dhe kushtet në të cilat ato jepen do të jenë objekt i marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, ndërmjet këtij vendi dhe Organizatës. Për sa kohë që mbetet nën detyrimin për të dhënë paradhënie, ky vend do të ketë një vend ex officio në Këshillin Ekzekutiv.

(b) Vendi i përmendur në nënparagrafin (a) dhe Organizata do të kenë secili të drejtën të anullojnë (tërheqin) detyrimin për të dhënë paradhënie, me njoftim me shkrim. Anullimi hyn në fuqi tre vjet pas fundit të vitit në të cilin është njoftuar.

(8) Kontrollin e llogarive e kryejnë, siç parashikohet ne rregulloren financiare, një ose më shumë vende të Unionit, ose kontrollorë të jashtëm të cilët, me pëlqimin e tyre, i emëron Kuvendi.

Neni 17

[Rishikimi i Nenit 13 deri në 17]

(1) Propozimet për ndryshimin e Nenit 13, 14, 15, 16 dhe të këtij Neni mund të iniciohen nga çdo vend anëtar i Kuvendit, nga Këshilli Ekzekutiv ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto propozime do t'u komunikohen vendeve anëtare të Kuvendit nga Drejtori i Përgjithshëm të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit të tyre nga Kuvendi.

(2) Çdo ndryshim të Neneve nga paragrafi 1 e miraton Kuvendi. Për miratim nevojitet shumicë prej tri të katërtave nga votat e dhëna; megjithatë, për çdo ndryshim të nenit 13 dhe të këtij paragrafi kërkohet shumicë prej katër të pestat e votave të dhëna.

(3) Çdo ndryshim i neneve nga paragrafi 1 hyn në fuqi një muaj nga data kur drejtori gjeneral do të pranojë nga tri të katërtat e vendeve që janë anëtarë të Kuvendit në momentin kur është miratuar ndryshimi, njoftime me shkrim për pranim, të bëra në përputhje me rregullat e tyre përkatëse kushtetuese. Çdo ndryshimi i tillë i miratuar i këtyre neneve i detyron të gjitha vendet që janë anëtarë të Kuvendit në momentin kur ndryshimi hyn në fuqi ose që do të bëhet anëtarë më vonë; megjithatë, çdo ndryshim me të cilin rriten detyrimet financiare të vendeve të Unionit i detyron vetëm ata ndër të cilët kanë njoftuar pranimin e tyre për këto ndryshime.

Neni 18

[Rishikimi i Nenit 1 deri në 12 dhe 18 deri në 30]

(1) Kjo konventë do t'i nënshtrohet rishikimeve me qëllim paraqitjen e ndryshimeve të natyrës së tillë që do të përmirësojnë sistemin e Unionit.

(2) Për këtë shkak do të mbahen konferenca, një pas një, në një nga vendet e Unionit midis përfaqësuesve të këtyre vendeve.

(3) Ndryshimet në Nenin 13 deri në 17 rregullohen nga dispozitat e Nenit 17.

Neni 19

[Marrëveshje të veçanta]

Nënkuptohet se vendet e Unionit kanë të drejtën të nënshkruajnë në veçanti midis tyre, marrëveshje të veçanta për mbrojtjen e pronësisë industriale, në qoftë se këto marrëveshje nuk do të ishin në kundërshtim me këtë konventë.

Neni 20

[Ratifikimi ose aderimi nga vendet e Unionit; Hyrja në fuqi]

(1)

(a) Çdo vend i Unionit që ka nënshkruar këtë Akt mund ta ratifikojë, e nëse nuk e ka nënshkruar mund të aderojë (qaset) në të. Instrumentet për ratifikim dhe aderim (qasje) depozitohen tek drejtori i përgjithshëm.

(b) Çdo vend i Unionit mund të deklarojë në instrumentin e tij për ratifikim ose aderim, se ratifikimi ose aderimi i tij nuk zbatohen mbi:

(i) Nenet 1 në 12, ose

(ii) Nenet 13 në 17.

(c) Çdo vend i Unionit, i cili në përputhje me nënparagrafin b) ka përjashtuar nga efektet e ratifikimit ose aderimit te tij një nga dy grupet e neneve nga ai nënparagraf, mund në çdo moment të mëvonshëm, të deklarojë se shtrin efektet e ratifikimit ose pranimit të tij në atë grup të neneve. Kjo deklaratë depozitohet tek drejtori i përgjithshëm.

(2)

(a) Në raport me dhjetë vendet e para të Unionit që i kanë depozituar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim pa bërë deklaratën që lejon paragrafi 1 nën 6) I), nenet nga 1 deri 12 hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë nga këto instrumente për ratifikim ose aderim.

(b) Në lidhje me dhjetë vendet e para të Unionit që i kanë depozituar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim pa bërë deklaratën që lejon paragrafi 1 nën b) II), nenet nga 13 deri 17 hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të dhjetë nga këto instrumente për ratifikim ose aderim.

(c) Nën varësi të hyrjes fillestare në fuqi, në bazë të dispozitave të nënparagrafëve a) dhe b), secili nga dy grupet e neneve nga paragrafi 1 nën b)i) dhe ii) dhe duke ju nënshtruar dispozitave nga paragrafi 1(b), nenet nga 1 deri 17 hyjnë në fuqi në lidhje me ndonjë vend të unionit, përveç ato nga nënparagrafi a) dhe b) që depozitojnë instrumentin për ratifikim ose aderim, si dhe në raport me ndonjë vend të Unionit që depoziton deklaratë duke zbatuar paragrafin 1 nën c), tre muaj pas datës së njoftimit nga ana e drejtorit të përgjithshëm, për depozitimin e tillë, përveç në qoftë se në vetë instrumentin ose në deklaratën e depozituar nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi në lidhje me atë vend, në ditën e caktuar si të tillë.

(3) Në lidhje me çdo vend të Unionit që deponon instrument për ratifikim ose aderim, nenet nga 18 deri 30 hyjnë në fuqi në ditën e parë kur njëri, cilido qoftë, nga grupet e neneve të paragrafit 1 pika b) do të hyjë në fuqi në raport me atë vend sipas paragrafit 2 pika a), b) ose c)

Neni 21
[Aderimi nga vendet jashtë Unionit; Hyrja në fuqi]

(1) Çdo vend jashtë Unionit mund të aderojë në këtë akt dhe kështu të bëhet anëtar i Unionit. Instrumentet e aderimit do të depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm.

(2)

(a) Në lidhje me çdo vend jashtë vendit që ka depoziton instrumentin e tij për aderim një muaj apo më shumë para datës së hyrjes në fuqi të dispozitave të këtij akti, ai hyn në fuqi në ditën kur dispozitat për herë të parë kanë hyrë në fuqi me zbatimin e nenit 20 paragrafi 2) nën a) ose b), përveç nëse në vetë instrumentin për aderim nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme, megjithatë:

(i) nëse nenet nga 1 deri 12 deri në atë ditë nuk kanë hyrë në fuqi, ky vend, gjatë periudhës kalimtare para hyrjes në fuqi të kësaj dispozite, në vend të tyre, do të jetë i detyruar nga dispozitat e neneve 11 deri 12 të aktit të Lisbonës,

(ii) nëse nenet nga 13 deri 17 deri në atë ditë nuk kanë hyrë në fuqi, ky vend, gjatë periudhës kalimtare para hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave, do të jetë i detyruar nga nenet 13 dhe 14 paragrafi 3,4 dhe 5 të Aktit të Lisbonës.

Nëse ndonjë vend ka caktuar ndonjë datë të mëvonshme në instrumentin e tij të aderimit, ky akt, lidhur me atë vend, hyn në fuqi në datën e caktuar në ate mënyrë.

(b) Në lidhje me ndonjë vend jashtë Unionit që ka depozituar instrumentin e tij të aderimit pas hyrjes në fuqi të vetëm një grupi të dispozitave të këtij akti, ose në ditën që i paraprinë për më pak se një muaj, ky akt hyn në fuqi, nën kushtet e parashikuara nën pikën a) tre muaj pas datës kur është njoftuar pranimi i tij nga Drejtori i Përgjithshëm, përveç nëse në instrumentin për aderim nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi, lidhur me atë vend, në atë datë të caktuar.

(3) Në lidhje me çdo vend jashtë Unionit që depoziton instrumentin e tij të aderimit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij akti në tërësi, ose më pak se një muaj përpara kësaj date, ky akt do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën është njoftuar pranimi i tij nga Drejtori i Përgjithshëm, përveç nëse në instrumentin për aderim nuk është caktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi, lidhur me atë vend, në atë datë të caktuar.

Neni 22
[Pasojat e Ratifikimit ose Aderimit]

Në varësi të mundësive të përjashtimeve të parashikuara në Nenin 20(1)(b) dhe 28(2), ratifikimi ose aderimi do të sjellë pranimin e të gjitha klauzolave dhe të gjitha avantazheve të këtij ligji.

Neni 23
[Aderimi në aktet e mëparshme]

Pas hyrjes në fuqi të këtij akti në tërësi, një shtet i caktuar nuk mund të aderojë në aktet e mëparshme të kësaj Konvente.

Neni 24
[Territoret]

(1) Çdo shtet në instrumentin e tij për ratifikim ose aderim, mund të deklarojë, ose me shkrim mund të njoftojë drejtorin e përgjithshëm kurdo qoftë më vonë, se kjo konventë zbatohet mbi gjithë ose një pjesë të territoreve, të përcaktuara në deklaratën ose njoftimin, për marrëdhëniet e jashtme për të cilat është përgjegjëse.

(2) Çdo shtet që jep deklarata të tilla ose ka bërë një njoftim të tillë, mund, në çdo moment, të njoftojë drejtorin e përgjithshëm se kjo konventë pushon së zbatuari mbi të gjithë ose një pjesë të këtyre territoreve.

(3)

(a) Çdo deklaratë e bërë sipas paragrafit (1) do të hyjë në fuqi në të njëjtën datë me ratifikimin ose aderimin në instrumentin e të cilit është përfshirë, dhe çdo njoftim i dhënë sipas këtij paragrafi do të hyjë në fuqi tre muaj pas njoftimit të Drejtorit të Përgjithshëm

(b) Çdo njoftim i dhënë në bazë të paragrafit (2) do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas marrjes së tij nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 25
[Zbatimi i Konventës në nivelin e brendshëm]

(1) Çdo vend që është palë në këtë konventë merr përsipër të miratojë, në përputhje me kushtetutën e tij, masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e kësaj konvente.

(2) Nënkuptohet se në momentin kur një vend depoziton instrumentin e tij të ratifikimit ose pranimit ai do të ketë mundësinë të zbatojë dispozitat e kësaj konvente në përputhje me legjislacionin e vet të brendshëm.

Neni 26
[Anullimi i marrëveshjes (tërheqja)]

(1) Kjo Konventë do të mbetet në fuqi në kohë të pacaktuar.

(2) Çdo vend mund të anullojë (të tërhiqet) këtë akt duke njoftuar tek Drejtori i Përgjithshëm. Ky anullim do të sjellë gjithashtu anullim të të gjitha akteve të mëparshme dhe do të prekë vetëm vendin që e bën atë, Konventa mbetet në fuqi dhe ka efekt të plotë për vendet e tjera të Unionit

(3) Anullimi (tërheqja) hyn në fuqi një vit pas ditës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar njoftimin.

(4) E drejta e anullimit e parashikuar nga ky Nen nuk do të ushtrohet nga asnjë vend para përfundimit të pesë viteve nga data në të cilën ai bëhet anëtar i Unionit.

Neni 27
[Zbatimi i akteve të mëparshme]

(1) Ky akt, për sa i përket marrëdhënieve ndërmjet vendeve në të cilat zbatohet, dhe në masën që ai zbatohet, do të zëvendësojë Konventën e Parisit të datës 20 mars 1883 dhe aktet pasuese të rishikimit.

(2)

(a) Përsa i përket vendeve në të cilat ky akt nuk zbatohet, por për të cilat zbatohet Akti i Lisbonës i 31 tetorit 1958, ky i fundit do të mbetet në fuqi në tërësi ose për aq sa ky Akt nuk e zëvendëson atë në kuptim të paragrafit (1).

(b) Gjithashtu, në lidhje me vendet në të cilat nuk zbatohet ky as Akt, as pjesët e tij, as Akti i Lisbonës, mbetet në fuqi Akti i Londrës i 2 qershorit 1934, në tërësi ose për aq sa ky Akt nuk e zëvendëson atë në kuptim të paragrafit (1).

(c) Gjithashtu, në lidhje me vendet për të cilat nuk zbatohet as ky Akt, as pjesë të tij, as Akti i Lisbonës, as Akti i Londrës, mbetet në fuqi Akti i Hagës i 6 nëntorit 1925, në tërësi ose për aq sa ky Akt nuk e zëvendëson atë në bazë të paragrafit (1).

(3) Vendet jashtë Unionit që janë palë në këtë akt e zbatojnë ndaj çdo vendi të Unionit që nuk është palë në këtë akt ose që, megjithëse është palë në këtë akt, ka bërë një deklaratë në përputhje me Nenin 20(1)(b)(i). Vende të tilla pranojnë se vendi i përmendur i Unionit mund të zbatojë, në marrëdhëniet e tij me ta, dispozitat e Aktit më të fundit në të cilin është palë.

Neni 28
[Mosmarrëveshjet]

(1) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë vendeve të Unionit që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, dhe që nuk zgjidhet me negociata, nga secili prej vendeve të interesuara, mund të paraqitet para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë në përputhje me Statutin e Gjykatës, përveç rasteve kur vendet e interesuara bien dakord për ndonjë metodë tjetër zgjidhjeje. Vendi që sjell mosmarrëveshjen përpara Gjykatës do të informojë Byronë Ndërkombëtare; Byroja Ndërkombëtare do të

njoftojë vendet e tjera të Unionit.

(2) Çdo vend, në momentin kur nënshkruan këtë akt ose depoziton instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit, mund të deklarojë se nuk e konsideron veten të detyruar nga dispozitat e paragrafit (1). Në lidhje me çdo mosmarrëveshje ndërmjet këtij vendi dhe çdo vendi tjetër të Unionit, nuk do të zbatohen dispozitat e paragrafit (1).

(3) Çdo vend që ka bërë një deklaratë në përputhje me dispozitat e paragrafit (2) mund, në çdo kohë, të tërheqë deklaratën e tij me njoftim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

(a) Ky akt do të nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhën franceze dhe do të depozitohet në Qeverinë e Suedisë

(b) Dokumentet zyrtare do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhët angleze, gjermane, italiane, portugeze, ruse dhe spanjolle dhe në gjuhë të tjera që Asambleja mund t'i caktojë.

(c) Në rast të mospërputhjeve të mendimeve për interpretimin e dokumenteve të ndryshme, do të mbetet ne fuqi dokumenti në frëngjisht.

(2) Ky akt do të mbetet i hapur për nënshkrim në Stokholm deri më 13 janar 1968.

(3) Drejtori i Përgjithshëm do t'u dorëzojë qeverive të të gjitha vendeve të Unionit dhe sipas kërkesës, tek qeveria e çdo vendi tjetër dy kopje, të vërtetuara nga Qeveria e Suedisë, të tekstit të nënshkruar të këtij akti.

(4) Drejtori i Përgjithshëm do ta regjistrojë këtë akt në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

(5) Drejtori i Përgjithshëm do të njoftojë qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit për nënshkrimet, depozitimin e marrëveshjeve të ratifikimit ose aderimit dhe çdo deklaratë të përfshirë në marrëveshje të tilla ose të bëra në përputhje me Nenin 20(1)(c), me hyrjen në fuqi të çdo dispozitë të këtij ligji, njoftimet e denoncimit dhe njoftimet në zbatim të Nenit 24.

Neni 30

[Dispozita kalimtare]

(1) Deri në marrjen e detyrës nga Drejtori i parë i Përgjithshëm, referimet në këtë akt ndaj Byrosë Ndërkombëtare të Organizatës ose Drejtorit të Përgjithshëm do të konsiderohen si referime përkatësisht ndaj Byrosë së Unionit ose Drejtorit të tij.

(2) Shtetet e Unionit që nuk përfshihen në Nenet 13 deri në 17, deri në pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës që themelon Organizatën, nëse dëshirojnë, munden të ushtrojnë të drejtat e parashikuara nga nenet 13 deri në 17 të këtij ligji si të ishin të përfshira nga këto Nene. Çdo vend që dëshiron të ushtrojë të drejta të tilla do t'i bëjë një njoftim me shkrim Drejtorit të Përgjithshëm; një njoftim i tillë do të ketë efekt që nga data e marrjes së tij. Këto vende do të konsiderohen se janë anëtarë të Asamblesë deri në përfundimin e periudhës në fjalë.

(3) Deri sa të bëhen anëtare të Organizatë të gjitha vendet e Unionit, Byroja Ndërkombëtare e Organizatës do të funksionojë gjithashtu si Byro e Unionit dhe Drejtori i Përgjithshëm si Drejtor i Byrosë në fjalë.

(4) Pasi të gjitha vendet e Unionit të bëhen Anëtare të Organizatës, të drejtat, detyrimet dhe pronat e Byrosë së Unionit do t'i kalojnë Byrosë Ndërkombëtare të Organizatës.